

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Fillim Skoro, kryetar, Vahid Halili dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në çështjen penale të akuzuarit I.B., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në tentativë, nga neni 147 par.1 nën par.7 lidhur me nenin 20 të KPK, të akuzuari P.H., për shkak të veprës penale shtytja në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë, nga neni 147 par.9 lidhur me nenin 20 dhe 24 të KPK dhe të akuzuarit T.P., për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë, nga neni 147 par.7 lidhur me nenin 20 dhe 25 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore-DKR në Pejë dhe ankesës së mbrojtësit të akuzuarit P.H., av. H.Ç., përgjigjes në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit T.P., av. Z.B., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Pejë, P.nr.63/2015, të dt.22.09.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur në kuptim të nenit 390 par.1 dhe 4 të KPPK-së, me dt.20.02.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.HUDHET e pa lejuar ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Pejë për pjesën gjyquese të aktgjykimit P.nr.63/2015, i dt.22.09.2016, sa i përket të akuzuarve I.B. dhe P.H..

II.Me miratimin e ankesës së Prokurorisë Themelore-DKR në Pejë, ANULOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Pejë me numër dhe datë si në pikën I të këtij vendimi, për pjesën liruese të aktgjykimit sa i përket të akuzuarit P.H. dhe për këtë pjesë lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim.

III.Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit P.H., REFUZOHET e pabazuar.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Pejë, P.nr.63/2015, të dt.22.09.2016 i akuzuari I.B., është shpallur fajtor për veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë, nga neni 147 par.1 nën par.7 lidhur me nenin 20 të KPK dhe për këtë vepër i është përcaktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vitesh, ndërsa dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 13 (trembëdhjetë) vitesh, sipas aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, p.nr.156/2009, të dt.04.09.2009, ia merr si të vërtetuar dhe të akuzuarin I.B., e

gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite dhe dënimi me burgim sipas aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, P.nr.156/2009, të dt.04.09.2009, i llogaritet paraburgimi dhe koha e mbajtjes së dënimit në vazhdim nga dt.05.08.2009, i akuzuari P.H., është shpallur fajtor për veprën penale shtytja në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë, nga neni 147 par.9 lidhur me nenin 20 dhe 24 të KPK dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej dt.16.01.2009, deri me dt.15.04.2009.

I akuzuari I.B., është detyruar ti paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 200Euro dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 25 Euro.

I akuzuari P.H. është detyruar ti paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 50 Euro dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 25 Euro.

I akuzuari T.P., në bazë të nenit 364 par.1 pika.1.3 të KPPK, është liruar nga akuza për veprën penale ndihma në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë, nga neni 147 par.7 lidhur me nenin 20 dhe 25 të KPK, për shkak se nuk është provuar se ka kryer veprën penale.

Shpenzimet e procedurës penale është vendosur të bijnë në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

I dëmtuari P.A., në raport me të gjithë të akuzuarit për realizmin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar në kontest civil.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Gjykata Themelore-DKR në Pejë, me aktvendim të veçantë P.nr.63/2015, të dt.19.12.2016, ka përmirësuar aktgjykimin me shkrim P.nr.63/2015, të dt.22.09.2016, në gabime teknike në dispozitiv për të akuzuarin I.B., në përcaktimin dhe llogaritjen e paraburgimit gabimisht të shkruar në aktgjykimin P.nr.156/09, të dt.04.09.2009, ashtu që duhet të jetë të akuzuarit I.B., për këtë vepër penale i përcakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, dënimi me burgim sipas aktgjykimit të kësaj gjykate P.nr.27/2010, të dt.14.06.2010, në kohëzgjatje prej 13 (trembëdhjetë) vitesh, konsiderohet si dënim i vërtetuar, ashtu që gjykohet me dënim me burgim të unifikuar në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite, e në dënimin me burgim sipas aktgjykimit P.nr.27/2010, të dt.14.06.2010, i llogaritet paraburgimi nga dt.05.08.2009, deri me dt.14.06.2010 dhe koha e mbajtjes së dënimit në vazhdim.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur:

-Prokuroria Themelore-DKR në Pejë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.

-Mbrotjtësi i të akuzuarit P.H., av. H.Ç., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe

vendimit mbi dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që i akuzuari P.H., të lirohet nga akuza ose aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.

-Përgjigje në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit T.P., av. Z.B., me propozim që ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë, të refuzohet si e pabazuar.

Prokuroria e Apelit, me shkresën PPA/I.nr.55/2017, të dt.24.01.2017, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Pejë dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet sa i përket pjesës gjykuar dhe të akuzuarve I.B. dhe P.H., t'iu shqiptohen dënime më të larta me burgim efektiv, ndërsa sa u përket pjesës liruese të aktgjykimit për të akuzuarin T.P., aktgjykimi të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim, të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit P.H. dhe përgjigja në ankesë e mbrojtësit të të akuzuarit T.P..

Gjykata në kuptim të nenit 390 par. 1 dhe 4 të KPPK, mbajti seancën e kolegjit në të cilën ishin prezent të akuzuarit I.B., P.H. dhe T.P., i autorizuari i të dëmtuarit av. H.M., mbrojtësi i të akuzuarit T.P., av. Z.B. ndërsa në seancë nuk prezantoi Prokurori i Apelit, i cili është njoftuar me rregull për seancën e kolegjit, i dëmtuari P.A., të cilit nuk ka mundur ti dorëzohet njoftimi, ndërsa në fletë kthesë është shënuar se "gjindet jashta shtetit", mbrojtësit e të akuzuarve av. A.M. dhe av. H.Ç., të cilët janë njoftuar me rregull për seancën e kolegjit, e meqenëse mbrojtësit e të akuzuarve nuk prezantuan në seancë, gjykata sipas detyrës zyrtare të akuzuarve I.B. dhe P.H., iu ka caktuar sipas detyrës zyrtare për mbrojtës av. G.B. dhe av. H.J.

I autorizuari i të dëmtuarit, av. H.M., deklaroi se përkrah ankesën e prokurorit të shtetit, mbrojtësi i të akuzuarit I.B., av. G.B., propozoi që ankesa e prokurorisë së shtetit të refuzohet si e pabazuar, mbrojtësi i të akuzuarit P.H., av. H.J., sqaroi pretendimet ankimore dhe deklaroi se mbetet pranë propozimit si në ankesë, ndërsa mbrojtësi i të akuzuarit T.P., theksoi se mbetet pranë propozimit si në përgjigje si në ankesë.

Të akuzuarit deklaruan se përkrahin propozimet e mbrojtësve të tyre.

Gjykata shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesën e Prokurorisë Themelore-DKR në Pejë, ankesën mbrojtësit të të akuzuarit P.H., dhe përgjigjen në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit T.P. dhe gjeti se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Pejë, sa i përket pjesës gjykuar për të akuzuarit I.B. dhe T.P., është e pa lejuar, ndërsa për pjesën liruese për të akuzuarin T.P., është e bazuar, ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuarit P.H., është e pabazuar.

Pretendimet për shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e gjykatës- për pjesën gjykuar të aktgjykimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit P.H., av. H.Ç., pretendon se aktgjykimi i ankimuar nuk ka arsyetim për mos përputhjen e dispozitivit, me dispozitivin e aktakuzës së konfirmuar dhe të zgjeruar sa i përket përshkrimin të fakteve.

Dispozitivi i aktakuzës së konfirmuar dhe aktakuzës së zgjeruar gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka pasur ndryshime në pjesën e përshkrimit të fakteve. Dispozitivi i aktgjykimit në pjesën e përshkrimit të fakteve nuk përputhet me dispozitivin e aktakuzës meqë është shkelur identiteti i akuzës dhe aktgjykimit, sidomos duke pasur parasysh mos përputhjen në fjalë, aktgjykimi nuk ka arsyetim. Kjo shkelje është absolute për të cilën gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Në dispozitivin e arsytimit të aktgjykimit është bërë një gjimnastikë juridike që nuk ka mbështetje në KPPK, ngase bëhet fjalë për një konstruksion juridik e cila ka mbështetje në një shkollë që ka shumë pakë përkrahës, krahasuar me shkollën tjetër të mbështetur nga doktrina juridike, që ka më shumë autor dhe përkrahës.

Këtë pretendim mbrojtja e bazon në specifikat që e kanë përcjellë fillimin e këtij procesi, janë paksa të pa zakonshme dhe indikative. Janë indikative ngase parashtrohet pyetja se për çfarë arsye K.B., nuk e paraqiti këtë rast në polici në Gjakovë, apo në policinë rajonale në Pejë, por drejtpërsëdrejti rastin e lajmëroi në prokurori në Pejë, madje drejt te prokurori Ndrec Dodaj dhe atë shkoi së bashku me I.B. dhe L.A.. Lidhur me këtë veprim të tij K.B., ka shpjeguar se arsyeja ka qenë se në polici po bëhet e madhe, ky shpjegim i të njëjtit dërgon te bindja e pa lëkundur se ishte projektuar një skenar nga i njëjti së bashku me T.P. dhe L.A., ashtu që sipas përpunimit të këtij skenari në lojë e kanë futur I.B., mirëpo, sido që të jetë në vijim mbrojtja do të paraqes të gjitha provat dhe faktet të cilat vërtetojnë një gjendje tjetër.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit P.H., se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, janë të pabazuara.

Aktgjykimi i ankimuar-pjesa gjykuese është hartuar ashtu si obligojnë dispozitat e nenit 370 par.4,6,7 dhe 8 i KPPK lidhur me nenin 365 par.1 nën par.1.1 të KPPK, kështu që në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur në mënyrë të plotë dhe të qartë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara. Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të veçantë ka vlerësuar provat kundërtënëse, arsyet në të cilën është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, e veçanërisht me rastin e vetëtimtimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit P.H., si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të Kodit Penal, ndaj të akuzuarit P.H. dhe veprës së tij.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se dispozitivi i aktgjykimit të fakteve nuk përputhet me dispozitivin e aktakuzës e me këtë është shkelur identiteti i akuzës dhe aktgjykimit, është i pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, dispozitivin e aktgjykimit e ka hartuar sipas provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe fakteve që ka vërtetuar nga provat e administruara, por gjykata e shkallës së parë, nuk ka ndryshuar identitetin e aktakuzës me aktgjykim si pa të drejtë pretendon mbrojtësi i të akuzuarit P.H..

Janë të pabazuara pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit P.H., se gjykata e shkallës së parë, në aktgjykimin e ankimuar ka bërë gjimnastikë juridike, sepse gjykata e shkallës së parë, nuk merret me atë se si është iniciuar procedura penale në rastin konkret, por gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të administruara ka vërtetuar gjendjen faktike edhe atë nga lista e dëshmvive nga vendi i ngjarjes nga nr.1-37,

foto dokumentacioni i vendit të ngjarjes, provave të tjera të administruara, e këtë gjendje faktike e ka përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit duke paraqitur arsye të detajuara në arsyetim të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë, për vërtetimin e gjendjes faktike ka dëgjuar dëshmitarët P.A., L.A., M.K., K.B., D.H., duke vlerësuar deklaratat e këtyre dëshmitarëve e duke dhënë arsye pse iu ka besuar deklaratave të këtyre dëshmitarëve

Gjykata e shkallës së parë, gjithashtu ka vlerësuar mbrojtjen e të akuzuarve I.B. dhe P.H., duke dhënë arsye pse nuk iu ka besuar mbrojtjes së të akuzuarve I.B. dhe P.H..

Nga arsyet që u thanë më lartë kjo gjykatë gjen se janë të pabazuara pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit P.H., se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sa i përket pjesës gjyqesive të aktgjykimit edhe atë për të akuzuarin P.H., meqenëse i akuzuari I.B., nuk ka paraqitur ankesë ndaj aktgjykimit me të cilin i njëjti është shpallur fajtor.

Pretendimet për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe gjetjet e gjykatës- për pjesën gjyqesive.

Mbrojtësi i të akuzuarit P.H., av. H.Ç., konsideron se një mori elementesh faktike, nuk janë vlerësuar drejt ose janë vlerësuar në bazë të kriterëve të njëanshme dhe të pa qëndrueshme. Aktgjykimi i kundërshtuar nuk mbështetet në prova të vërtetuara në shqyrtim gjyqësor.

Në rastin konkret disa fakte që janë vërtetuar nuk janë vlerësuar drejt.

Në rastin konkret nuk është kontestues fakti se natën kritike rreth orës 19:00, ka ndodhur vepra penale e vrasjes në tentativë kundër të dëmtuarit P.A.. Gjykata me të drejtë konstaton se plagosja e tani të dëmtuarit P.A., është pasojë e goditjes me armë zjarri të shkrepur nga distanca prej 20m. Se kryes i kësaj veprë në tërësi është vërtetuar se është tani i gjykuari I.B., për çka i njëjti është deklaruar fajtor edhe në aktgjykimin e parë. I.B., ka dhënë shpjegimet e veta lidhur me të gjitha veprimet e tij, ka shpjeguar bisedën e zhvilluar me dëshmitarin K.B., përgatitjet e bëra paraprakisht, për veprimet dhe bisedat me K.B., T.P., për mënyrën e kryerjes së veprës penale, për takimet e tij, pas kryerjes së veprës penale si dhe për bisedat e zhvilluara mes tij K.B., L.A. dhe persona tjerë me të cilët është takuar dhe janë dakorduar për ta lajmëruar rastin në Prokurorinë e Qarkut në Pejë, te prokurori Ndrec Dodaj. E tëra çka ka deklaruar është konstatuar në procesverbal në prokurori dhe në shqyrtimin gjyqësor.

Gjykata e shkallës së parë, gabon ku në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar P.H., e shpallë fajtor dhe atë për qëllime të hakmarrjes ndaj familjes A., e aq më tepër gabon kur mes tjerash thotë se i njëjti ka dyshuar në këtë familje, kinse për vrasjen e vëllait të tij në vitin 2004, duke shtuar më tutje se me dashje e shtytë të akuzuarin I.B.. Mbrojtja konsideron se ky përfundim është i gabuar ngase në asnjë mënyrë e me asnjë provë nuk është vërtetuar se i mbrojturi im ka ndërmarrë cilindo veprim i cili kishte për të involvuar në këtë çështje penale.

Fillimisht duhet shikuar se P.H., a kishte motiv për ta privuar nga jeta L.A.. Përfundimi është se i njëjti absolutisht nuk kishte motiv ngase asnjëherë nuk ka dyshuar në familjen A., se janë kryes të vrasjes së N.H. (vëllait të P.H.), përkundrazi i njëjti dyshimin e kishte adresuar te familja N., edhe atë B.N., këtë fakt e kanë vërtetuar edhe dëshmitarët gjatë shqyrtimit të parë, prandaj është i çuditshëm ky konkludim fillimisht i prokurorit të çështjes i cili ka ngritë akuzës, pastaj i gjykatë që të njëjtin e shpallë fajtor.

Konsideroj se është dashur të vlerësohen deklaratat e dëshmitarëve T.P., K.B., të akuzuarit I.B., pastaj të dëmtuarit P.A., D.H. dhe M.K., e po që se bëhet një vlerësim i tillë analitik rezulton se:

Dëshmitari K.B., dëshminë e tij të dhënë disa herë në prokurori dhe në shqyrtim gjyqësor, me deklaratimet e tij ka vërtetuar veprimet e tij gjatë takimit me T.P. dhe I.B..

I njëjti ka deklaruar se ka biseduar me T.P., me ç'rast T.P. ka kërkuar nga i njëjti për ta gjetur një snajper, ndërsa i njëjti iu ka përgjigj se kam menduar se mi ke sjellë parat. T.P. ka insistuar që t'ia gjej një njeri patjetër, duke ia treguar emrin e të njëjtit dhe vendin e punës në restorantin "NN", se T.P. kishte shkuar dhe kishte blerë atë snajper. Pas dy, tri jave T.P., prapë e kishte thirrë në telefon të njëjtin dhe ish-in takuar në restorantin në Gjakovë dhe kinse T.P. e ka njoftuar se me te është edhe një person që e ka emrin P. Sipas tij T. e kishte njoftuar se P.H. është i interesuar për hakmarrje se ia kanë vrarë vëllain dhe T. P. kishte kërkuar nga ky që t'ia gjej një njeri që mund ta kryej këtë punë, për çka i njëjti deklaroi se nuk e ka kundërshtuar duke shtuar se gjatë bisedës ka kuptuar se P.H. kishte të holla dhe se K.B. siç thotë ai mua më interesonte ti nxjerr paratë e mia dhe nuk e ka pyetur fare se kush është personi që do të vritet, pastaj pas këtij takimi e ka takuar I.B. në Gjakovë, me T.P., por sipas tij gjithnjë qëllimi ka qenë që ti nxjerr paratë.

Se për çka i kishte dhënë K. ato para T.P.t, i njëjti shpjegon se kishte dhënë shumë prej 19.000,00\$, T.P. që ti dërgoj në SHBA.

Në procesverbalin e dt.15.04.2016, K.B., shpjegon më ndryshe lidhur me veprimet e tij e në faqen e dytë pasusi i dytë deklaroi se në vitin 2008, ka qenë i thirrur në telefon nga T.P. dhe ka menduar se T.P. do t'ia kompensoj paratë e duke shtuar se nuk ka mundësi, por është një mundësi se P.H., duhet me ja gjet një person me qëllim të hakmarrjes për vëllain e tij të cilin ia kanë vra, e kur mua P.H., mi jep paratë unë ta kompensoj borxhin. Sipas tij T.P. prapë ka kërkuar nga i njëjti që të takohen në dalje të Gjakovës me te dhe P.H..

Pas një jave kinse prapë e ka thirr K.B., T.P. me telefon që të takohen me I.B. dhe P.H., mirëpo, shton se para se me u takuar ka biseduar me I.B. duke kërkuar nga i njëjti që a mundet me ua kryer vrasjen.

I njëjti ka shpjeguar se qëllimi i tij e bisedat e zhvilluara me T.P., ka qenë kthimi i borxhit nga ana e T.P., ndërsa për të vërtetuar ndonjë prej veprimeve inkriminuese të mbrojturit tim me asnjë mënyrë me shpjegimet e tij nuk ka arritur që të vërtetoj.

T.P., në tërësi ka kundërshtuar deklarinimin e tij, duke mohuar çdo bisedë apo marrëveshje për çka K.B. është deklaruar, mirëpo, i njëjti pos tjerash ka deklaruar se me P.H., kanë qenë komshi dhe nuk janë

ndarë kurrë, duke shtuar se me te asnjëherë nuk ka biseduar apo planifikuar vrasjen e kujtdo qoftë, e lëre më të familjes A..

Për mbrojtjen është e çuditshme se si ky dëshmitar për veprimet e bëra nuk është akuzuar as me akuzën e parë e as me akuzën e dytë, është i çuditshëm konkludimi i gjykatës kur thotë se ia ka falë besimin këtij dëshmitari, kur ai ka deklaruar se me kërkesën e P.H., është takuar me I.B., të cilin e ka pasur shok të shkollës fillore, se janë marrë vesh me I.B. i cili ka pranuar të kryej ato veprime.

Me asnjë mënyrë dhe me asnjë argument nuk është vërtetuar se është ndërmarr një veprim i tillë me kërkesë të P.H..

Gjykata ka konstatuar se K.B., është dëshmitar kontrovers dhe i prirë për ndryshmin e deklaratave dhe shtrembërimin e shpjegimit të ngjarjes, duke shtuar se sidoqoftë i ka falur besimin.

T.P. kishte një mos marrëveshje me familjen A., lidhur me një borxh prej 10.000,00Euro i cili ishte me fajde dhe ishte rritur në 40.000,00Euro. Duke pasur parasysh këto rrethana të rëndësishme si dhe rolin e T.P. në skenën e ngjarjes, mendoj se shkakun e saj që ka ndodhur duhet kërkuar te ky borxh, pikërisht te kërkesa që të kthehen 40.000,00Euro dhe se pista e vërtetë e dyshimit duhet vërtetuar se T.P., ishte shtrënguar për ta kthyer atë shumë për të cilën nuk kishte mundësi financiare dhe se kjo rrethanë mund ti ketë lindur idenë T.P. dhe me besueshmëri mund të them se ai fillimisht bie në kontakt me K.B., i cili paraqet idenë se kinse P.H., është interesuar për ta gjetur një njeri për një vrasje me pagesë, për çka K.B. kontakton I.B., dhe së bashku me T.P. shpjegojnë I.B., interesin kinse të P.H., për kryerjen e një vrasje.

Kjo vërtetohet edhe nga thënia e I.B., në shqyrtimin gjyqësor ku thotë “unë për parat kam folur me K.B., sepse së pari ka qenë iniciativa nga ana e K.B., e pastaj nga ana e T.P.”. Unë në fillim kam kuptuar prej K.B. dhe T.P. se çka duhet të bërë për ti marrë parat dhe kënd duhet ta vras, e në këtë rast nuk përmendet fare P.H..

Gjatë shqyrtimit të parë dhe të dytë, është thënë se kinse për tu kryer vepra fillimisht janë marrë vesh që të bëhet përcjellja e L.A., duke ndarë rolet, kinse nëse L.A. vjen nga Gjakova, për ardhjen e tij me telefon të lajmëroj P.H., ndërsa nëse L.A. del nga fshati në drejtim të Gjakovës, me telefon të lajmëroj T.P.. Nuk është provuar një veprim i tillë.

Gjykata gabon kur deklaratën e dëshmitares R.H., e konsideron si irelevante sepse ajo ka deklaruar se N.A.1, nga ajo ka kërkuar që të deklaron—të flet keq e më keq për P.H..

Gjatë shqyrtimit gjyqësor propozimi i mbrojtjes për të dalë në vend të ngjarjes është refuzuar për shkak të shumë rrethanave të pa sqaruara.

Sido që të jetë si gjatë shqyrtimit të parë ashtu në rigjykim me asnjë provë nuk është arsyetuar të provohet fajësia e të pandehurit P.H., nëse i njëjti nuk ka pasur motiv e as që është vërtetuar dashja e tij që të kryej veprën penale të nxitjes për çka edhe akuzohet, ngase për të ekzistuar një vepër e tillë penale duhet të plotësohen të gjitha kushtet ligjore e për ta sjellë të njëjtin në këtë gjendje ka ndikuar skenari i përgatitur nga ana e personit të cekur më lartë.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit P.H., se gjykata e shkallës së parë, nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike, atë që e ka vërtetuar është e gabuar janë pretendime të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë, ka administruar prova duke lexuar raportin mbi vend shikim, duke bërë shikimin në foto dokumentacionin e vendit të ngjarjes, duke bërë shqimin në raportin e ekzaminimit të veturës me regjistrim ..., raportin e ekzaminimit të gëzhgojave, raportin mjeko ligjor për P.A., raportin e ekzaminimit balistik të gëzhgojave, marrëveshjen për pajtim të lidhur në mes familjes A. dhe familjes së të akuzuarit I.B., duke dëgjuar dëshmitarët P.A., L.A., M.K., K.B., D.H., duke dëgjuar të akuzuarit I.B., P.H. dhe T.P., e pas vlerësimit të provave të administruara ka vërtetuar gjendjen faktike se:

I akuzuari I.B., me dt.05.03.2008, rreth orës 19:00, në fshatin..., Komuna e Gjakovës, me qëllim të përfitim material me dashja ka tentuar ta privoj nga jeta të dëmtuarin P.A., në atë mënyrë që disa ditë para natës kritike, me ndërmjetësimin e T.P. dhe K.B., është takuar me të akuzuarin P.H., në lokalit "NN", në Gjakovë, ky i fundit me qëllim të hakmarrjes ndaj familjes A., në të cilët ka dyshuar për vrasjen e vëllait të tij në vitin 2004, disa ditë më parë ia ka premtuar shumën prej 20.000,00Euro, për kryerjen e vrasjes së L.A., pasi që janë marrë vesh për detajet e kryerjes së veprës penale, i akuzuari I.B. është bindur dhe ka pranuar e pas përgatitjeve të kryera më parë, i armatosur me armë zjarri të kal.7.65mm, me qëllim që ta vras L.A., ka shkuar natën kritike dhe është pozicionuar në rrugë në hyrje të fshatit ..., me të vërejtur që vetura e tipit "Pasant", pronë e L.A., është duke ardhur nga fshati në drejtim të shtëpisë së familjes A., nga një distancë prej 20m, shtënë me armë në drejtim të veturës dhe i zbrazë së paku 34 fishek, 13 prej tyre në makinën në lëvizje, me një predhë e godet në dorën e djathtë vozitësin, të dëmtuarin P.A., duke i shkaktuar lëndim, e pastaj është larguar nga vendi i ngjarjes.

I akuzuari P.H., më parë në Gjakovë, e gjerë me dt.05.03.2008, rreth orës 19:00, në fshatin ..., me qëllim të hakmarrjes ndaj familjes A., në të cilët ka dyshuar për vrasjen e vëllait të tij në vitin 2004, me dashje e ka shtyrë të akuzuarin I.B., që të kryejë vrasjen e L.A., në atë mënyrë që disa ditë para natës kritike me ndërmjetësimin e T.P. dhe K.B., është takuar në lokalit "NN", në Gjakovë, me të akuzuarin I.B., e këtij të fundit i ka premtuar shumën prej 20.000,00Euro, për kryerjen e vrasjes së L.A., atë e ka bindur dhe ka pranuar, e pasi që janë marrë vesh për detajet e kryerjes së veprës penale dhe pas përgatitjeve të kryerja më parë natën kritike me dt.05.03.2008, rreth orës 19:00 i akuzuari I.B. me qëllim që ta vras L.A., ka shkuar dhe është pozicionuar në rrugë në hyrje të fshatit ..., me të vërejtur makinën e tipit "Pasant", pronë e L.A., të cilën në atë moment e drejtonte i dëmtuari P.A., nga një distancë prej 20m, shtënë me armë dhe i zbrazë së paku 34 fishek, 13 prej tyre në makinën në lëvizje, një predhë e godet në dorën e djathtë shoferin këtu të dëmtuarin P.A., duke i shkaktuar lëndim dhe pastaj është larguar nga vendi i ngjarjes.

Këtë gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, e aprovon edhe kjo gjykatë si gjendje faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë.

Para se kjo gjykatë të jap gjetjet e saja dhe të përgjigjet në pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit P.H., kjo gjykatë do të jap theksimet e disa nga provat e administruara.

Dëshmitari K.B., në shqyrtimin gjyqësor me dt.20.06.2016, ka theksuar:

Unë kam dhënë deklaratë dy herë në prokurori, herën e fundit me dt.15.04.2015 dhe në tërësi qëndroj pranë atyre deklaratave. Deklaratë në prokurori kam dhënë me dt.13.01.2009. Para se të shkoj me dhënë deklaratë kam pasur një takim me L.A. dhe I.B..

I.B. e njoh, ai tri vitet e shkollës fillore i ka kryer fshatin tim. P. e njoh nga viti 2004. T.P. në vitin 2004 apo 2005, e kam takuar në shtëpinë e tij. Ai më ka premtuar mua dhe djalit të axhës që të na dërgoj në Amerikë. Me organizimin e tij me vetura jemi nisur në botën e jashtme, në Bullgari na kanë arrestuar, për atë shërbim unë dhe djali i axhës tim A. i kemi paguar 19.000,00\$. Unë vazhdimisht T.P, ia kam kërkuar këto para. Në vitin 2008 T.P. më ka kërkuar në telefon dhe ka kërkuar një takim. Unë kam menduar se ka për qëllim të mi kthej parat dhe jam takuar me atë në rrugën transit në Gjakovë.

Atë ditë T.P. ka ardhur së bashku me të akuzuarin P.H., me një xhip të zi. P.H. ka ndenjur në veturë. T.P. ka dalë dhe nga unë ka kërkuar që t'ia siguroj një armë, më tha se po i vyen. I thash se nuk merrem me atë punë. Pastaj T.P. e kam takuar me një person të quajtur D., mbiemrin nuk ia di, ai punon si kamerier, unë më vonë jam njoftuar se personi i quajtur D., se T.P. e P.H. kanë marrë një armë nga ai. Pas dy muajsh T.P., ka kërkuar një takim me mua. Përsëri jemi takuar në restorantin "KK"; në Gjakovë, aty ka qenë P.H. dhe T.P.. T.P. më tha se P.H., dikush ia ka vra një vëlla dhe kërkoi nga unë që t'ia gjej një person në mënyrë që ai të merr hak për T.P., njëherit më premtoj se nëse unë ia gjej personin T.P. të mi kthej të hollat që mi kishte borxh. Ai më tha se gjëja P.H. me ia dhënë të hollat e ai me mi kthyer mua borxhin për shërbimin që unë ta kryej në mënyrë që unë ta gjej personin. Në atë bisedë nuk është përmend se kush është personi që është me u vra, ndaj cilit person me marrë hak. Pas dy javësh apo një muaji, kam komunikuar me telefon me T.P.. Në ndërkohë jam takuar me I.B. dhe kam biseduar me ta. Unë u mora vesh me I.B., që ai të pranoj që ti kryej ato veprime. U morëm vesh që kur unë ta marr borxhin tim, I.B. i thashë se ti jep 2.000,00Euro, por u morëm vesh që I.B. të mos veproj derisa ti marrim të hollat. Pas një muaji jemi takuar unë I.B., P.H. dhe T.P.. Jemi takuar në restorantin "KK"; në Gjakovë. Në atë takim kanë biseduar pa praninë time I.B., T.P. dhe P.H., e sipas mendimit tim ata kanë biseduar lidhur me vrasjet. Pas këtij takimi unë nuk kam pasur ndonjë takim me I.B. e as me T.P.. Pas dy apo tre muajve T.P. më ka thirr me telefon dhe më tha se ka ndodhur një plagosje në fshatin ..., T.P. më tha se e kanë plagosur djalin e T.A.. Unë atëherë e mora vesh se ku ka qenë caku kryesor. Paratë që mi ka borxh T.P., asnjëherë nuk mi dhënë. Borxhin që ka pasur me mi dhënë T.P. ka qenë rreth 14.000,00Euro, kështu jemi marrë vesh se ai nuk ka pasur dollarë e të mi kthejë në Euro.

Rreth një javë pas ngjarjes jemi takuar me I.B., e kam pyetur se a është ai kryes i kësaj vepre, në fillim ka thënë jo, pastaj më ka thënë se unë e kam kryer.

Unë i thashë se do të lajmëroj në polici. Para se të lajmëroj rastin jam takuar me L.A. dhe personin M., në një restorant në Radavc. I.B., ia ka shpjeguar L.A. se si ka ndodhur ngjarja. I.B. e ka shpjeguar se si e ka gjuajtur personin. Prej aty kemi shkuar në prokurori.

Para se unë ta kem takimin me L.A. dhe I.B., në lokaln në fshatin Radavc, kam pasur një takim në shtëpinë e L.A. dhe aty ka qenë edhe T.P.. Është biseduar për këtë rast.

T.P., ia ka treguar L.A., përkatësisht ia ka përshkruar personin që i ka kryer veprimet, se është një djalë i "çubardham", përkatësisht ka shpjeguar dukjen e të akuzuarit I.B.. T.P. dhe unë te L.A., u morëm

vesh të deklarojmë në prokurori, L.A. kërkoi nga ne që ne vetëm të tregojmë të vërtetën, por T.P. është larguar nga Kosova.

Krejt këtë çka unë kam deklarua e kam thënë vullnetarisht, pa presion nga askush, e di se edhe I.B. deklaratën e ka dhënë vullnetarisht.

Në pyetje të përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit, av. H.M., gjegjësisht pasi dëshmitarit i lexohet pjesa e deklaratës e dt.15.04.2016, faqja 3, pasusi i fundit edhe atë konstatimi se në prezencën time është bërë pazari se nëse kryhet vepra parat në shumë prej 15.000,00Euro të merren nga T.P. e që ka për ti dhënë P.H., ky konstatim është i saktë.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor i akuzuari I.B., parashtimin e pyetjeve dëshmitarit e ka kushtëzuar duke kërkuar që procedura penale e përfunduar për të cilin është gjykuar të rishqyrtohet dhe të sqarohet se dëshmitari a është bashkëkryes, se vepra është kryer me iniciativën e tij.

Takimin me D., ia propozova sepse e kam ditur se ai merret me sigurimin e armëve.

Në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor është konstatuar ju thatë se T.P., i ka dhënë informata L.A. për veprimet e P.H..

Këtë e thashë se T.P. ia shpjegoi L.A. krejt ngjarjen përkatësisht ia përshkroi personin i cili i ka kryer veprimet.

Unë kam qenë prezent sikur deklarova në restorant "KK", kur T.P., P.H. dhe unë kemi biseduar për ngjarjen.

Në vitin 2006 me T.P. kam pasur një shitblerje të automjetit, ai më ka borxh 3.000,00\$ për një veturë që ia kam shitur.

Personi me emrin D., ka punuar në restorant te "ZZ".

D. më ka treguar se P.H., e ka blerë armën dhe ia ka dhënë paratë.

Për ngjarjen e dt.05.03.2008, më njoftoi me telefon T.P., ai vetëm më tregoi se e kanë plagosur djalin e T.A.. Te L.A., kam shkuar tre apo katër muaj pas ngjarjes, pasi e mora informatën për ngjarje. Atje kam shkuar pasi e kam pasur bisedën për ngjarjen me I.B. dhe T.P., por vazhdimisht kam marrë premtim nga T.P., që ai të me qes jashtë apo të mi kthej paratë, bisedat i kemi bërë nga shkaku se unë kam insistuar që ta lajmëroj rastin, por ata nuk kanë pranuar.

I.B. ka shpjeguar ngjarjen kur kemi qenë në takim me L.A. dhe M.K. në një restorant në Radavc, aty I.B. ka qarë duke shpjeguar ngjarjen.

Në pyetje të akuzuarit I.B., a është e vërtetë se ju shtatë muaj pas rastit keni kërkuar nga unë që të bëjë me juve një marrëveshje, unë të marrë përsipër këtë vepër dhe që në këtë proces të dalim si dëshmitar kundër P.H., dëshmitari përgjigjet se kjo nuk është e vërtetë.

Nuk është e vërtetë se Ndrec Dodaj, të na ketë premtuar shumën prej 20.000,00Euro, për ta mbyllur këtë rast.

Dëshmitari L.A., në shqyrtimin gjyqësor me dt.30.06.2016, ka theksuar:

Kam dhënë deklaratë në prokurori me dt.21.01.2009, kam thënë të vërtetën. Gjithashtu kam dhënë deklaratë edhe me dt.10.03.2016 dhe kam thënë të vërtetën. Me dt.05.03.2008, kam qenë në Klinë. Në fshat jam kthyer rreth orës 19:30, kam takuar djalin e vëllait tim P.A., i cili kishte qenë me J.N.. I thashë djalit të vëllait qoje J.N. në shtëpi e unë hyra në shtëpinë time. Për ngjarjen dhe personat që kanë marrë pjesë në këtë ngjarjes unë kam bërë një hetim dhe kam marrë informatë nga një person që nuk dëshiroj ta implikoj në këtë çështje dhe pastaj informatën kryesore e kam marrë nga i akuzuari T.P.. Me T.P. jemi fqinj, me të njëjtin nuk kam pasur ndonjë konflikt, është e vërtetë se T.P., vëllait tim i ka pasur borxh 10.000,00Euro. Babai im T.P., ia ka kërkuar kthimin e borxhit. Me P.H., kemi pasur një konflikt rreth vitit 2003, për një tokë shoqërore. Për këtë tokë me familjen e P.H. jemi gjuajtur, por nuk ka pasur pasoja e pastaj jemi pajtuar.

Pas plagosjes së P.A., T.P., është takuar me djalin e axhës N.A.2, që ka ardhur në pushim nga Kroacia, ai kishte thënë N.A.2 se L.A., nuk e ka punën mirë, është në rrezik se dojnë me e vra. Ai ka thënë se është në rrezik për ta vvarë P.H..

Unë në atë kohë nuk folsha me T.P., i cili më parë ka qenë shokë i ngushtë me vëllain tim të ndjerë, T.A., ai nuk erdhi fare në ngushëllime e kjo ka qenë arsyeja pse nuk folsha me te. Mbi bazën e njoftimit unë fola me T.P.. T.P. më tha ruaju se nuk e ke punën mirë, është kah donë P.H me të vra dhe kur është plagosur P.A. ti ke qenë personi që është dashur me u vra. T.P. më tha se P.H., ka dyshime se vëllai që iu ka vra, për të njëjtin dyshon se ti apo familja juve, e keni vra. Ky takim me T.P. ka qenë pas dy apo tre muajve.

K.B. ishte njoftuar se unë kam ardhur në dijani për ngjarjen dhe ai ka kërkuar një takim me mua dhe këtë takim e kemi bërë në restorantin "PP", në Gjakovë, në takim kam qenë unë dhe K.B.. K.B i thashë se je i involvuar në vrasjen e djalit të vëllait tim. Pas dy muajve kemi lënë takim me K.B., në motelin "TT", aty kam shkuar me M.K.. Kur i tregova fotografinë K.B. në të cilën foto ka qenë mixha i K.B. B.A., që është axha tani i të akuzuarit I.B., e që ka pasur mbiemrin e dajve. Kjo fotografi është bërë në lokalin "NN", në Gjakovë.

Meqë K.B. e dinte se unë nuk foli me T.P., ndërsa që ai nuk e dinte se unë isha duke folur me T.P. fshehtazi, ai vazhdimisht gjatë ditës rrinte me P.H., ndërsa natën vinte te unë e më tregonte çdo gjë. Kur unë ia shpjegova disa gjëra K.B se kam zbuluar rastin ai pikërisht për këtë që e dinte se gjëja unë nuk foli me T.P., më tha me më dhënë kohë derisa të takohem me T.P. dhe pastaj të tregoj. Pastaj kemi shkuar në shtëpinë time. K.B. e ka ftuar në telefon T.P.. K.B i tha T.P.: T., L.A. ka qenë sot në Klinë dhe e kishte zbuluar rastin, ai po e dinte ngjarjen në detale, e K.B më tha se T.P. i tha mos për riza të zotit.

T.P. i tha K.B. thirre P.H. e tregoj për këtë ngjarje.

Pas disa orëve K.B. e ka ftuar përsëri T.P. dhe i tha se unë kam ardhur në ..., në shtëpinë e L.A.. T.P i tha se po vij dhe nuk erdhi. Unë pastaj e kam ftuar në telefonin e bashkëshortes së të akuzuarit T.P.. Ajo më tha se ka shkuar te P.H.. I thashë thirre T.P. e mos trego se e kam thirr unë se ke dikënd mysafir. Pas pak e thirra T.P. në telefon dhe më tha se jam në shtëpi, i thashë a po vjen se jemi duke pirë kafe, pastaj ka ardhë. Kur erdhi T.P. në shtëpi, ishim prezent unë, K.B., M.K. dhe T.P.. K.B i tha T.P., L.A. e dinë

krejt ngjarjen e çka ka ndodhur është më mirë të deklarojmë, përkatësisht ta lajmërojmë rastin. K.B. i tha T.P. du me lajmëru rastin për atë çka ka ndodhur. T.P. i tha jo për riza të zotit se me lajmërua rastin ne biejmë në gjak me P.H.. T.P. i tha se me ra në gjak bjen me mua, se unë jam plagosur e jo P.H.. K.B. e luti që ta lajmëroj rastin, T.P. nuk pranoi. Këtë bisedë që e patëm unë e kam të incizuar me një aparat të vogël.

Pas nja dy jave pas bisedës së fundit me K.B., në Radavc aty prezent ka qenë I.B. dhe M.K., por para këtij takimi e kisha një takim me P.K., B.A. dhe M.K., e patëm në restorantin "DD", në Klinë, këtë takim e kemi bërë me iniciativën e B.A., axhës së të akuzuarit I.B..

Kur ia shpjegova I.B., atë që dija për ngjarjen ai në fillim mohoi e pastaj filloi të qaj, i thashë qetësohu nuk ke nevojë vetëm duhet të tregosh të vërtetën, ai më tha se do të tregoj të vërtetën.

Ai pastaj (I.B.), tha se është takuar me iniciativën e K.B. me T.P. dhe P.H.. Ai më njoftoi se P.H. ka thënë se ka nevojë me gjet një person me vra dikend. Ai tha se i kishte thënë P.H. më ka vra një vlla dhe unë jam i plagosur dhe për personin që do ta kryej a të punë, i ka premtuar 20.000,00Euro. I.B. më tha se unë e kam pranuar këtë ofertë. Ai shpjegoi se P.H. më ka treguar se kush është personi që duhet me vra. Tha se i ka treguar vendet përkatësisht lokalet ju ku rrimi, ai tha se më ka dërguar në fshatin ... dhe më ka treguar disa pozita ku me u pozicionua. Atje më ka dërguar me një taxi ngase më tha P.H. se me shkuar me veturën time më njohin në fshat. I.B. më tha mua se P.H. i ka thënë se unë ta bijë armën edhe ashtu kemi vepruar.

Në momentin kur I.B. qajti tha se do të tregoj të vërtetën nëse ti mua më fal, unë i thash se nëse fol të vërtetën kam me të fal. I.B. imë tha se veprën e ka kryer me axhën tim B.A. dhe kërkoi nga unë që mos ta lajmëroj B.A. që ka qenë pjesëmarrës. Unë i premtova se nëse e tregon të vërtetën se kush është prapa kësaj vrasje nuk do të lajmëroj axhën e tij B.A.. Atë ditë vendosëm që rastin ta lajmëroj I.B.. Unë kam shkuar atë ditë në Pejë në restorantin "LL" që ka qenë afër prokurorisë, unë kam qëndruar aty ndërsa K.B. dhe I.B. shkuan për ta lajmëruar rastin.

Takimin e fundit që kam pasur në shtëpinë time me T.P., të nesërmen e kam ftuar me telefon dhe e kam njoftuar se bisedën që e kam zhvilluar e kam incizuar me telefon, nga ai moment T.P. nuk e kam parë e as që jam takuar me te, si e di nga ai moment ka dalë jashtë shtetit.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata ka bërë ballafaqimin e të dëshmitarit L.A. me të akuzuarin T.P., gjatë të cilit ballafaqim i akuzuari T.P., i thotë dëshmitarit se ajo që thatë ju për takimin që kam pasur në shtëpinë tuaj për veç faktit që është biseduar për ngjarjen dhe personat e dyshuar nuk ka pasur bisedë tjetër.

Ndërsa dëshmitarit i është përgjigjur duke thënë se betohet se atë çka ka thënë është e vërtetë dhe qëndron pranë saj.

I akuzuari I.B. në shqyrtimin gjyqësor me dt.28.08.2009, ka deklaruar:

Është e vërtetë se unë kam deklaruar te prokurori me dt.13.01.2009, se ditën kritike me dt.05.03.2008, rreth orës 19:30, në fshatin ..., kam shtënë në një automjet dhe është lënduar një person. Unë nuk kam pasur problem me askënd, por kam pasur për detyrë që të gjuaj në L.A. të cilin nuk e kam njohur.

Në pyetje se a e njeh P.H., përgjigjet: unë e kam njohur përmes K.B. dhe T.P.. Jemi takuar në lokalin "NN", në afërsi të stacionit të autobusëve në Gjakovë. Unë së pari jam takuar me K.B., i cili më ka thënë se duhet kryer një punë dhe duhet vrarë L.A., një njeri i keq nga fshati Në këtë ndërmjetës ka qenë T.P., gjegjësisht në mes P.H. në një anë dhe mua e K.B. në anën tjetër. K.B. më ka thënë se interes për vrasjen e L.A., ka personalisht P.H. dhe ai duhet të paguajë për atë vrasje 20.000Euro. T.P. ka qenë ndërmjetësues dhe njëherit përcjellës i të gjithë ngjarjes, gjegjësisht është dashur të ofroj të gjitha informatat e nevojshme për lëvizjen e L.A.. Pas disa ditëve jam takuar me P.H., në hotelin "KK", në Gjakovë, prezent ka qenë P.H., unë dhe K.B.. Jemi marrë vesh bashkërisht rreth detaleve të kryerjes së vrasjes. K.B. atëherë më prezantoi P.H. dhe më sqaroi rastin e tij, më përmendi vrasjen e vëllait të tij, por unë nuk jam kyçur në këtë tregim sepse nuk më ka interesuar. Marrëveshja ishte që P.H. t'ia jap paratë K.B., K.B. të mi jep paratë mua pas kryerjes së vrasjes.

Nga kjo bisedë që kemi pasur kuptova se P.H., është i interesuar që për atë ta kryej këtë vrasje, ashtu më ka shpjeguar edhe K.B. dhe aty e kemi përfunduar të gjithë bisedën. Mua më është sqaruar ku është vendi i kryerjes, cili është objekti dhe si do ta kryej veprën. Unë përsëri pas kësaj ngjarje jam takuar me T.P. në kafenenë, gjegjësisht qebaptoren "NN", dhe jemi marrë vesh rreth kryerjes së kësaj marrëveshje. Pas kësaj jam takuar me K.B. në Klinë, atëherë K.B. e ka thirr me telefon T.P.. Para se të takohem me P.H. e T.P. dhe K.B. në hotelin "KK", mua K.B. më ka dërguar në vendin ku duhet të kryhej vrasja, më ka treguar atë vend, kemi qenë me veturën e tij të markës "Opel Astra", rreth dy javë para ngjarjes kritike, ai atëherë në veturën e tij kishte armën automatike me të cilën është dashur të kryhet vepra. Unë tri apo katër ditë para ngjarjes kritike përsëri kam shkuar në vendin e ngjarjes ku më ka dërguar K.B.. Është e vërtetë se në hetime kam thënë se më ka dërguar P.H., por për të thënë kështu më ka shtyrë K.B. që unë të kaloj më mirë në këtë rast.

Para ngjarjes kritike unë kam qenë në vendin e ngjarjes me K.B. dhe ai më ka lënë në vendin e ngjarjes, më ka lënë edhe armën dhe telefonin mobil ku unë është dashur ta kryej vrasjen, por atëherë në veturë kishte shumë njerëz, unë atëherë kam heq dorë nga ajo.

Unë atëherë me telefon e kam lajmëruar K.B. dhe ai ka ardhur me veturë dhe më ka marrë.

Unë vetëm me telefon jam dëgjuar me T.P. dhe i kam lajmëruar se çka ka ndodhur e ai ka thënë se edhe më tutje do ta përcjell dhe se do të më lajmëroj kur të jetë rasti më i përshtatshëm.

Unë kam biseduar edhe me P.H. dhe ai më ka thënë se do të më lajmëroj kur të jetë rasti.

Natën kritike në vendin e ngjarjes përsëri më ka quaj K.B. me automjet dhe më ka lënë në të njëjtin vend, më ka dhënë pushkën automatike, i kam pasur dy shanzhera me fishek. Derisa kam qenë në vendin e ngjarjes kam pasur kontakte telefonike me T.P. dhe me P.H.. T.P. ishte në shtëpinë e tij dhe ai e përcillte lëvizjen e veturës dhe është obliguar se do të më lajmëroj kur të arrij automjeti. Gjithashtu kam biseduar me P.H. me telefon, ai ka pasur detyrë kur të arrijë vetura. P.H. ka qenë në lëvizje diku në mes qytetit dhe fshatit, nuk jam i sigurt ku. P.H. ka pasur për detyrë që të më lajmëroj nëse vetura vjen nga drejtimi i qytetit, e T.P. nëse vetura vjen nga drejtimi i shtëpisë.

Ishte natë dhe binte shi.

Kur ka mbërri vetura i pari më ka lajmëruar me telefon P.H.. Në fillim i kam vërejtur dy persona në atë veturë dhe atëherë nuk kam gjuajtur, një person doli nga vetura gjegjësisht është bartë deri te një shtëpi e në kthim në timon ka qenë vetëm një, gjegjësisht ka qenë vetëm një person.

P.H. më ka thënë se automjeti po vjen dhe të përgatitem. Nuk kam mundur të vërej se kush është në automjet.

Unë kam qenë në anën e djathtë nga automjeti larg rreth 20-25m. Kam gjuajtur me rafal. Kur automjeti arriti ka ngadalësuar para gropave në rrugë dhe unë kam filluar të gjuaj, nuk i kam ndërprerë gjuajtjet, pastaj automjeti për një kohë të shkurtër ka lëvizur ngadalë, pastaj ka filluar të rrisë shpejtësinë dhe unë kam vazhduar të gjuajë, ashtu që në ndërkohë e zbraza një shanzher dhe menjëherë e shtina shanzherin tjetër, ndërsa shanzherat kanë qenë të lidhur me izolir. Me këtë rast i kam zbrazur të dy shanzherat. Unë nuk kam shikuar kur e kam pranuar armën nga K.B. se sa fishek ka, por e di se të gjithë fishekët i kam shkrepur. Kam shtënë në anën e djathtë të automjetit dhe kam goditur automjetin në atë anë. Pas gjuajtjeve jam nisur në drejtim të Drinit, armën e kam gjuajtur në lumin "Drin", e në lum e kam gjuajtur edhe telefonin e markës "Nokia", në të cilin ka qenë kartela e telefonit të markës "II", i cili numër nuk më kujtohet.

Unë armën dhe telefonin mobil e kam gjuajtur sipas udhëzimeve që mi ka dhënë K.B. dhe P.H..

Unë jam takuar me K.B. pas katër apo pesë ditëve pas ngjarjes kritike, sepse ai më ka thirr në telefon. Unë kam pasur telefon tjetër dhe numër tjetër sepse ai e ka pasur numrin tim i cili ka qenë numri i vjetër. Unë tani në bisedë me K.B. kam kuptuar se e kam plagosur një person tjetër e jo L.A.. Më ka thënë se puna nuk është kryer. Pas një muaji jam takuar me P.H. e kjo ishte me iniciativën dhe organizimin e K.B., sepse me këtë isha non stop në kontakt, jemi takuar në hotelin "KK". Kemi biseduar rreth këtij rasti i cili nuk kishte përfunduar. P.H. më ka thënë atëherë se pasi puna nuk është përfunduar nuk ka as para, e pasi të përfundoj puna do të mi jap paratë. Mi ka dhënë 2.000,00Euro, atë ditë, parat mi ka dhënë P.H..

Pas disa ditëve K.B. mi ka dhënë 3.000,00Euro. Edhe herën e parë edhe herën e dytë parat i kam ndarë me K.B. përgjysmë. Atëherë ka qenë prezent vetëm K.B. Unë akoma jam takuar me T.P. dhe K.B. dhe të dytë më kanë vërtetuar se kur të përfundoj puna do ta marrë pjesën tjetër të parave. Në ndërkohë pas këtyre takimeve na kemi kuptuar se kemi gabuar dhe kemi hequr dorë nga angazhimi në këtë vepër. Ne jemi takuar edhe njëherë, jemi takuar me P.H. në qebaptoren "NN", por jemi takuar rastësisht dhe nuk kemi biseduar më për këtë punë sepse kemi heqë dorë nga kjo.

Është e vërtetë se përsëri jam takuar me K.B., por nuk është e vërtetë ajo që kam thënë në prokurori sepse unë jam shty nga ana e K.B., që të jap deklaratë të atillë dhe është e vërtetë ajo që po them sot.

Mua P.H., më nuk më ka thirrë dhe nuk më ka kanosur, e atë çka e kam thënë në prokurori e kam thënë sepse më ka shtyrë K.B. ashtu të dëshmoj.

Gjatë gjithë kohës unë kam komunikuar nëpërmes rrjetit "II", i kam pasur dy apo tre numra të cilët mi ka blerë K.B..

Paratë më janë nevojitur për me dalë jashtë.

Unë nuk kam kërkuar para me kamat nga P.H..

K.B. ka pasur para dhe unë nuk di nga i ka marrë, ai ka dërguar njerëz në botën e jashtme, me këtë është marrë.

Të dy herët ka qenë arma e njëjtë, i kam pasur nga dy shanzhera. Unë e kam kryer gjuajtjen kur vetura ishte në largësi 40m nga pozicioni im.

Është e vërtetë se P.H. më ka thënë kur jemi takuar me K.B. në restorantin "KK", se puna nuk është kryer dhe nuk ka para, ka thënë se kur të kryhet puna do ti marr paratë. Koha për përfundim të veprës së saktë nuk ka qenë e përcaktuar, por është dashur të kryhet sa më parë. Bankënotat që i kam marrë kanë qenë në apoena nga 500Euro.

Ditën kritike kur kam gjuajtur, kur ka ra shi kam qenë i veshur me rrobe të zeza, në kokë nuk kam pasur asgjë, kam qëndruar në atë vend rreth gjysmë ore deri në një orë para se kam gjuajtur. Pas gjuajtjes pushkën e kam vendosur në krah dhe ashtu e kam bartë deri te lumi sepse pushka ka pasur rrypinë e saj. Pasi e kalova lumin "Drin", sipas marrëveshjes u takova me K.B. në fshatin ... në anën tjetër të Drinit.

Unë kam qenë në shtëpinë e T.P. dhe e di se ku e ka shtëpinë.

Në pyetje se a e dinë shtëpinë e L.A., është përgjigjur:

Shtëpitë e tyre nuk janë shumë larg dhe janë afër njëra tjetrës, shtëpia e L.A., nuk është e rrethuar, nga shtëpia e T.P., shihet shtëpia e L.A..

Unë kam qenë edhe në shtëpinë e P.H..

Në shtëpinë e T.P., nuk e kam takuar P.H..

Se çfarë kanë qenë raportet në mes të K.B. dhe T.P., më parë nuk e di.

Lidhur me paratë unë kam biseduar me K.B..

Në pyetje se e kujt ka qenë iniciativa për kryerjen e kësaj vepra, i akuzuari përgjigjet:

Së pari ka qenë iniciativa e K.B., e pastaj edhe nga T.P..

Unë së pari kam kuptuar nga K.B. dhe T.P. se unë çka duhet të bëjë për ti marrë paratë dhe kënd duhet ta vras.

Në pyetjen se personalisht a e ka pa P.H. atë ditë që ke ardhur në vendin e ngjarjes, e kur nuk ke gjuajtur?

I akuzuari përgjigjet P.H. nuk e kam parë, por jemi dëgjuar përmes telefonit edhe me P.H edhe me T.P..

Në pyetje se a i keni njohur zërat e T.P. dhe P.H. dhe a i dallon zërat e tyre?

I akuzuari përgjigjet unë mirë i kam dalluar zërat e tyre.

Në pyetje se a je i sigurte?

I akuzuari përgjigjet po.

Në pyetje se K.B. a të ka thënë çka duhet të bësh më tutje, kur të ka lënë në vendin e kryerjes?

I akuzuari përgjigjet më ka thënë se tani do të më thërras P.H. dhe T.P., sepse unë i kam pasur numrat e tyre të telefonave.

Ditën kritike nuk e kam parë T.P. dhe P.H., por jemi dëgjuar me telefona.

Unë kam marrë thirrje telefonike për arritjen e automjetit kur automjeti arriti herën e parë nga drejtimi i Gjakovës, tani nuk kam gjuajtur. Automjeti shkoi nga shtëpia e familjes A. në drejtim të fshatit, përsëri kam marrë telefonat dhe më ka thirr T.P. dhe më ka lajmëruar për arritjen e veturës. Herën e parë në telefon më ka thirr P.H., i cili më lajmëroi për arritjen e automjetit. Herën e tretë më ka thirr T.P. dhe më ka lajmëruar se po arrin vetura dhe unë tani kam shtënë në veturë. Herën e parë nuk kam shtënë sepse dikush ishte në veturë.

Shumën e parave prej 2.000,00Euro ma ka dhënë K.B..

Pas rastit gjegjësisht pas ngjarjes jam takuar me L.A., në rrugë për në Radavc dhe pas takimit me atë kur më ka sqaruar se e gjitha është zbuluar unë kam vendosur që të jap deklaratë dhe deklaratën e kam dhënë të prokurori dhe nuk më kujtohet saktë sa kohë ka kaluar pas kryerjes së veprës penale.

Në pyetje se kush ka qenë prezent në takimin me L.A., i akuzuari përgjigjet:

Ka qenë prezent K.B., gjegjësisht unë dhe K.B. jemi nisur për ta takuar L.A., ndërsa L.A. ka qenë me njëfarë M., mbiemrin e të cilit nuk ia di. Aty kemi biseduar rreth ngjarjes, K.B. tha ta pranojmë, ta thojmë të vërtetën se na kanë zbuluar. Na i kemi pranuar L.A. gjithë atë që e kemi bërë. K.B. më ka thënë se T.P. të gjitha i ka thënë dhe i ka zbuluar të gjitha dhe K.B. atëherë më ka thënë se ai të gjitha i ka pranuar dhe duhet ti pranoj edhe unë. Pas kësaj më nuk jam takuar me L.A., më duket se pas kësaj bisede të nesërmen e kam lajmëruar rastin. K.B. më sugjeroj që të shkojmë te prokurori dhe bashkërisht shkuam. Me T.P. më nuk jam takuar.

Në këtë çështje penale nuk është kontestuese se i akuzuari i parë I.B., me dt.05.03.2008, rreth orës 19:00, në fshatin ..., Komuna e Gjakovës, me armën automatike kishte shtënë në të dëmtuarin P.A., së paku 34 fishek, me dashje që të njëjtin ta privoj nga jeta, por të dëmtuarin P.A., e kishte goditur vetëm një predhë në dorën e djathtë, kështu që vepra e të akuzuarit I.B., kishte mbetur në tentativë.

Nuk është kontestuese se I.B. me familjen A., nuk kishte asgjë të keqe, prandaj, i njëjti nuk pati motiv për hakmarrje personale ndaj familjes A., por pati një motiv tjetër.

Nga dëshmia e dëshmitarit K.B., L.A., vërtetohet fakti se i akuzuari P.H., kishte kërkuar një vrasës me pagesë sipas një varianti për shkak të dyshimit se L.A., kishte dorë në vrasjen e vëllait të tij në vitin 2004. Po ashtu sipas dëshmisë së dëshmitarit K.B. dhe L.A., vërtetohet fakti se nëpërmes dëshmitarit K.B. dhe ndërmjetësimit të T.P., kishin siguruar të akuzuarin e parë që për pagesën në shumë prej 20.000,00Euro ta privoj nga jeta dëshmitarin L.A.. Ditën kritike L.A., me veturë të markës "Pasar", kthehet

në shtëpinë e tij, rrethanat e rastit dashtën që menjëherë tani i dëmtuari P.A., një person ta dërgoj te shtëpia e tij, e në kthyerje i akuzuari I.B., duke menduar se me veturë është i dëmtuari L.A., shtiu në shoferin që ishte duke drejtuar veturën e ky ishte i dëmtuari P.A., i cili nga shtënjet e të akuzuarit I.B., me një predhë është qëlluar në krah.

Nga dëshmia e dëshmitari K.B., L.A., vërtetohet fakti se pikërisht i akuzuari P.H., nëpërmes dëshmitarit K.B. dhe të akuzuarit T.P., kishin siguruar të akuzuarin I.B. që i njëjti për shumën prej 20.000,00Euro, ta privoj nga jeta dëshmitarin L.A., por si u sqarua më lartë për shkak të rrethanave të caktuara ku në veturë ishte P.A., i njëjti u plagos nga i akuzuari I.B..

Pra, nga dëshmitari K.B. dhe L.A., vërtetohet fakti se i akuzuari P.H., i kishte premtuar të akuzuarit I.B., që për pagesën për shumën prej 20.000,00Euro, ta privoj nga jeta dëshmitarin L.A., pra, me provat e administruara vërtetohet fakti se i akuzuari P.H., për qëllim të hakmarrjes e shtyu të akuzuarin I.B., që ta privoj nga jeta të dëmtuarin P.A..

Dëshmitë e dëshmitarëve K.B. dhe L.A., i vërteton edhe i akuzuari I.B..

Pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit P.H., se akuzimi dhe shpallja fajtor e të akuzuarit P.H., është një skenar i përgatitur, janë pretendime të pa bazuara, në kundërshtim me provat e administruara e drejtuar në ikje nga përgjegjësia penale e të akuzuarit P.H..

Deklarata e dëshmitarit K.B., në pikat kryesore është bindëse, te deklaratat e të njëjtit ka disa lëvizje në interesin e tij, por të njëjtat janë të kuptueshme sepse i njëjti me veprimet e tij ka hyrë në zonën kriminale dhe i njëjti tenton ta lehtësoj pozitën e tij.

Sa i përket të akuzuarit T.P., një fakt është i pa kontestueshëm se i njëjti në këtë rast ka pasur rol të dyfishtë sepse i njëjti ditën ka qëndruar me familjen e të akuzuarit P.H., ndërsa natën ka qëndruar me familjen e dëmtuar A., por faktet vendimtare për rolin e të akuzuarit T.P., do të vërtetohen në rigjykim.

Nga çka u tha më lartë kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike sa i përket të akuzuarit P.H. dhe rolit të tij në shtytjen e I.B. Berishës që të privoj nga jeta të dëmtuarin L.A., i cili ka shtënë me armë në të dëmtuarin P.A., të cilit i ka shkaktuar lëndime trupore, prandaj, vepra e të akuzuarit I.B., ka mbetur në tentativë.

Pretendimet e shkeljes së ligjit penal dhe gjetjet e gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.Ç., pretendon se gjykata e shkallës së parë ka shkelur ligjin penal në dëm të akuzuarit P.H.. Shkelja e ligjit penal është pasojë direkte e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe pasoja e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Në rastin konkret në asnjë mënyrë nuk mund të bëhet fjalë për vepër penale të shtytjes në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 147 par.9 lidhur me nenin 24 dhe 20 të KPK, ashtu si gabimisht ka gjetur gjykata e shkallës së parë.

Sipas mendimit të mbrojtjes gjatë shqyrtimit gjyqësorë është vërtetuar se i akuzuari P.H., nuk është implikuar në këtë vepër penale.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit P.H., se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit janë të pabazuara.

Si është thënë në arsyetimin e këtij aktgjykimi nga kjo gjykatë, kjo gjykatë ka gjetur se janë të pabazuara pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e gjithashtu janë të pabazuara pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se në aktgjykimin e ankimuar gjendja faktike nuk është vërtetuar e drejtë e ajo çka është vërtetuar është e gabuar, prandaj, kjo gjykatë është përgjigjur në pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit.

Në nenin 24 të KPK, është paraparë që kushdo që me dashje e shtytë tjetrin të kryej vepër penale dënohet sikurse ai ta kishte kryer atë vepër penale, nëse vepra penale është kryer në ndikimin e tij.

Në rastin konkret si është thënë edhe më herët në arsyetim të këtij aktgjykimi i akuzuari I.B., asgjë nuk kishte të keqe me familjen e dëmtuar A., por i akuzuari P.H., me premtimin e pagesës që i bëri të akuzuarit I.B., se do t'ia paguajë shumën prej 20.000,00Euro, për ta vrarë L.A., e shtyti të akuzuarin I.B. që ta privoj nga jeta L.A., por si është thënë disa herë gjerë më tani në veturë qëlloi nipi i tij P.A., në të cilin i akuzuari I.B. shtiu me automatik, kështu që i akuzuari P.H., ka vepruar me vetëdije dhe vullnet për ta shtyrë I.B., në kryerjen e veprës penale, i akuzuari I.B. veprën e ka kryer nën ndikimin e të akuzuarit P.H., prandaj, gjykata e shkallës së parë, drejt ka zbatuar ligjin penal, kur ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit P.H., ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale shtytje në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë nga neni 147 par.1 nën par.9 lidhur me nenin 24 dhe 20 të KPK, për të cilën vepër penale edhe e ka shpallur fajtor të akuzuarin, pasi më parë ka gjetur se penalisht është përgjegjës.

Gjykata e shkallës së parë, drejt ka zbatuar ligjin penal kur ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit P.H., qëndrojnë elemente të kualifikuara të vrasjes, sepse i akuzuari P.H., donte ti hakmerrej familjes A..

Nga këto arsye që u thanë më lartë kjo gjykatë gjen se janë të pabazuara pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit.

Pretendimet për shkak të vendimit mbi dënim dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria pretendon se gjykata me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dënimit ka pasur parasysh rrethanat rënduese për të akuzuarin I.B., ka vlerësuar këmbëngulësinë për të privuar nga jeta tani viktimën, motivi nga e cila është kryer vepra penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale nga pusia, qëllimin e të akuzuarit për fshehjen e krimit, veprime këto që paraqesin shkallë të lartë të intensitetit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, sjelljen e të akuzuarit para kryerjes së veprës, faktin se i njëjti më parë ka kryer veprën penale të vrasjes dhe është gjykuar, kurse si rrethana lehtësuese për të akuzuarin

ka vlerësuar shkallën e vogël të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, faktin se i dëmtuari ka pësuar lëndim të lehtë trupor, faktin se me palën e dëmtuar janë pajtuar, moshën e re, shfaqjen e pendimit.

Për të akuzuarin P.H., si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar motivin e hakmarrjes, qëllimin e kryesit për fshehjen e krimit, e këto paraqesin shkallë të lartë të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, mos shfaqja e pendimit për veprën e kryer, ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar shkallën e vogël të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, faktin se i dëmtuari ka pësuar një lëndim të lehtë trupore. E pastaj faktin se si rrjedhojë e kësaj ngjarje i akuzuari P.H., ka humbur përkatësisht i janë vra dy anëtar të familjes.

Sipas prokurorisë rastin konkret dënimet e shqiptuara nuk janë në përpjesëtim të drejtë me shkallën e përgjegjësisë penale për secilin të akuzuar, sidomos për të akuzuarin I.B., i cili edhe më parë ka qenë i gjykuar për vrasje. Sipas bindjes së prokurorisë e me dënimet e shqiptuara nuk do të arrihet qëllimi i dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit pretendon se shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe zbatimi i gabuar i ligjit penal, vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike kanë pasur për pasojë të natyrshme vendimin të pa drejtë për dënim.

Meqenëse nuk ka pasur bazë të shpallet fajtor i akuzuari për veprën penale nuk ka pasur bazë për gjykim me dënim.

Pretendimet e prokurorisë se dënimet e shqiptuara të akuzuarit I.B. dhe P.H., janë të buta, në këtë pjesë ankesa është e pa lejuar, ndërsa pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit P.H., se dënimi i shqiptuar është i ashpër, është i pabazuar.

Ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Pejë, është e pa lejuar sipas parimit "reformatio in peius", i paraparë në nenin 395 të KPPK.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, P.nr.156/2009, të dt.04.09.2009, i akuzuari I.B., është shpallur fajtor për veprën penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 par.7 lidhur me nenin 23 të KPK dhe për këtë vepër është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5(pesë)vite, ndërsa i akuzuari P.H. është shpallur fajtor për veprën penale të nxitjes në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 147 par.9 lidhur me nenin 20 e 24 të KPK dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5(pesë)vite.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit I.B., av. S.S., mbrojtësja e të akuzuarit P.H., av.N.K.-M. dhe i dëmtuari P.A..

Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendimin AP.nr.97/2010, të dt.18.11.2011, me rastin e ankesës së mbrojtësit të akuzuarit P.H., e sipas detyrës zyrtare e ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, P.nr.156/2009, të dt.04.09.2009 dhe lëndën ia ka kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Sipas të njëjtit aktvendim të Gjykatës Supreme të Kosovës, ankesa e mbrojtësit të akuzuarit I.B. dhe ankesa e të dëmtuarit P.A., është konstatuar se është jo lëndore.

Sipas nenit 395 të KPPK parimit “reformatio in peius”, në qoftëse është paraqitur ankesë vetëm në dobi të të akuzuarit, aktgjykimi sa i përket cilësimit juridikë të veprës penale dhe sanksionit penal nuk mund të ndryshohet në dëm të tij.

Meqenëse Prokuroria e Qarkut në Pejë, nuk ka paraqitur ankesë në aktgjykimin P.nr.156/2009 të dt.04.09.2009, por ky aktgjykim është anuluar sipas ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit P.H. edhe sipas detyrës zyrtare, tani Prokuroria Themelore-DKR në Pejë, nuk mund të paraqes ankesë kundër aktgjykimit P.nr.63/2015, të dt.22.09.2016 (vendim i marrë në rigjykim), sepse me këtë shkelje parimin “reformatio in peius”, që është paraparë në nenin 395 i KPPK, sepse Prokuroria e Qarkut nuk ka paraqitur ankesë, por vendimi i ankimuar është anuluar sipas ankesës së të akuzuarit P.H., prandaj, i akuzuari me ankesën e tij, nuk mund ta keqësoj pozitën e tij juridike, që gjykata të shqiptoj dënim më të lartë, për këtë arsye ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Pejë është hedhur si e pa lejuar sa i përket pjesë gjykuese dhe vendimit për dënim për të akuzuarit I.B. dhe P.H..

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të dënimeve për të akuzuarit ka pasur parasysh rrethanat që ndikojnë në llojin dhe masën e dënimit, kështu si rrethana rënduese të akuzuarit I.B., i ka marrë parasysh këmbëngulësinë për ta privuar nga jeta viktimën, motivin nga i cili është kryer vepra penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale nga pusia, qëllimi i të akuzuarit për fshehjen e krimit, veprime këto që paraqesin shkallë të lartë të intensitetit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer. Sjellja e të akuzuarit para kryerjes së kësaj veprë penale, faktin se edhe më parë ka kryer vepër penale të vrasjes dhe është gjykuar, ndërsa si rrethana lehtësuese janë marrë shkalla e vogël e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, faktin se i dëmtuari ka pësuar një lëndim të lehtë, pastaj faktin se me palën e dëmtuar është pajtuar, moshën e tij të re dhe pendimin për veprën penale të kryer.

Si rrethanë rënduese për të akuzuarin P.H., gjykata ka marrë motivin nga e cila është kryer vepra penale-hakmarrja, qëllimi i të akuzuarit për fshehjen e krimit, veprime këto të cilat paraqesin shkallë të lartë të intensitetit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, mos shfaqja e pendimit për veprën e kryer, ndërsa si rrethana lehtësuese janë marrë shkalla e vogël e dënimit të vlerës së mbrojtur-faktin se i dëmtuari ka pësuar një lëndim të lehtë, pastaj faktin se si rrjedhojë e kësaj ngjarje i akuzuari P.H. ka humbur përkatësisht janë vrarë edhe dy anëtarë të familjes.

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese që i ka pasur parasysh gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të dënimit për të akuzuarit I.B. dhe P.H., i aprovon edhe kjo gjykatë përpos motivit nga i cili kanë kryer veprat penale të akuzuarit, sepse si i akuzuari I.B., po ashtu edhe i akuzuari P.H., janë shpallur fajtor për vepra penale të kualifikuara, te të cilat motivi është element qenësor i veprave penale për të cilat janë shpallur të akuzuarit fajtor, prandaj, motivi në rastin konkret nuk mund tu merret të akuzuarve si rrethanë rënduese me rastin e caktimit të dënimeve.

Mbrojtësi i të akuzuarit P.H., në ankesë nuk thekson asnjë rrethanë konkrete e cila kishte me ndikuar që të akuzuarit P.H., ti shqiptohet një dënim më i butë, nga ai i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, sa i përket pretendimit për tri bazat ankimore që pretendon mbrojtësi i të akuzuarit kjo gjykatë ka dhënë gjetjet e saj, e meqenëse mbrojtësi i të akuzuarit nuk thekson asnjë rrethanë konkrete që kishte me ndikuar në shqiptimin e një dënim më të butë, atëherë kjo gjykatë gjen se pretendimi i mbrojtësit të akuzuarit se dënimi i shqiptuar të akuzuarit P.H., është i ashpër, është i pabazuar.

Si është thënë më lartë kjo gjykatë i aprovon si rrethanat lehtësuese po ashtu edhe rrethanat rënduese, e sipas gjetjes së kësaj gjykate dënimet e shqiptuara i përgjigjen shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale për të cilat janë shpallur fajtor të akuzuarit I.B. dhe P.H., si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarve, sepse mënyra e veprimet të tyre paraqet një shkallë të lartë të rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale dhe sipas bindjes së kësaj gjykate vetëm me dënimet e shqiptuara do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të akuzuarve I.B. dhe P.H., i paraparë në nenin 41 të KPRK, e që është të parandaloj të akuzuarit nga kryerja veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloj persona tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprat penale, të ndikoj në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit, për respektimin e ligjit.

Pretendimet për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e gjykatës-për pjesën liruese të aktgjykimit.

Prokuroria në ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë, me rastin e marrjes së aktgjykimit lirues gabimisht ka vërtetuar disa fakte të rëndësishme të cilat kanë ndikuar në marrjen e aktgjykimit lirues për të akuzuarin T.P.. Fillimisht nuk ka vlerësuar drejt deklaratën e dëshmitarit K.B., i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se pas kryerjes së veprës penale në dëm të P.A., T.P. e ka telefonuar K.B. dhe e ka njoftuar se është plagosur djali i T.A., dhe atëherë dëshmitarit K.B. ka kuptuar që P.H. nga T.P., ka kërkuar që të gjej një person që të vret dikën nga familja A.. Pas rastit K.B., është takuar pastaj me I.B., ku i akuzuari I.B. i kishte treguar K.B. se si e kishte kryer këtë vepër dhe se si T.P. dhe P.H., i kishin premtuar të holla në shumë prej 20.000Euro, prej të cilave I.B. ka marrë 5.000Euro, deklarata e K.B. është në pajtim me mbrojtjen e të akuzuarit I.B., të dhënë më parë, me dëshminë e L.A., por edhe pjesërisht me deklaratën e të akuzuarit T.P., i cili si në prokurori ashtu në shqyrtim gjyqësor nuk ka mohuar takimet dhe prezencën e tij në takimet e bëra mes K.B., I.B. dhe P.H.. A nuk është e mjaftueshme për gjykatën se këto deklarata që vërtetojnë se T.P. me qëllim të kompensimit të bordit në shumë prej 15.000Euro, që kishte ndaj dëshmitarit K.B., përmes këtij të fundit T.P. njoftohet me të akuzuarin I.B., e më pas të akuzuarin I.B., T.P. e njofton me të akuzuarin P.H., i cili e arrin ta shtytë të akuzuarin I.B., ta kryej veprën penale për të cilën është akuzuar.

Po ashtu gjykata nuk ka vlerësuar drejt nenin 33 par.2 të KPK, ashtu që në faqen 25, pika 14, pasusi i dytë i aktgjykimit, gjykata ka konstatuar se “ndihma përfshinë këshillimin ose udhëzimin se si të kryhet vepra penale, etj”, nëse i referohej nenin 33 par.2 të KPK, ligji ka paraparë se ndihma për kryerjen e veprës penale përfshinë, por nuk kufizohet në dhënien e këshillave ose udhëzimeve se si kryhet vepra penale, prandaj, gjykata në mënyrë jo të drejte dhe të gabuar ka vlerësuar se nuk është provuar se T.P., këtë e ka këshilluar apo të ketë vënë në dispozicion të akuzuarit I.B. mjetet për kryerjen e veprës penale, ti ketë ndaluar pengesat apo ti ketë premtuar se do ti ketë fshehur provat, identitetin e kryesit apo mjetet e përdorura, aq më pakë përfitimet që kanë rrjedh nga kryerja e veprës penale. Prokurori konsideron se roli dhe qëllimi i të akuzuarit T.P., lidhur me njoftimin e të akuzuarit I.B. me të akuzuarin P.H. si dhe veprimet tjera konsiderohen ndihmë edhe pse në nenin 33 të KPK, nuk ceket deçitivisht.

Pretendimet e prokurorisë se pjesa liruese e aktgjykimit për të akuzuarin T.P., është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, është e bazuar.

Sipas gjetjes së kësaj gjykate aktgjykimi lirues për të akuzuarin T.P., është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 nën par.1.12 lidhur me nenin 370 par.7 të KPPK, sepse për faktet vendimtare ka kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit, se nuk është provuar se i akuzuari T.P., ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, e kjo lidhur me përmbajtjen e shkresave edhe atë të deklaratave të dëshmitarëve K.B., L.A. dhe mbrojtjes së të akuzuarit I.B., për të cilën çështje kjo gjykatë në mënyrë detale ka paraqitur përmbajtjen e deklaratave të këtyre personave të gjendja faktike, e meqenëse aktgjykimi i ankimuar për pjesën liruese është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, i njëjti për këtë pjesë duhet të anulohet.

Meqenëse pjesa liruese e aktgjykimit është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale kjo gjykatë nuk mund të procedoj më tutje sipas neni 403 të KPPK, prandaj, kjo pjesë u dashtë të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Në rigjykim për të akuzuarin T.P., gjykata e shkallës së parë, duhet të mënjanojë shkeljet e theksuara më lartë, të administroj provat e propozuara, duke i pasur parasysh edhe pretendimet tjera të prokurorisë në ankesë, pastaj të marr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga çka u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 400,401 dhe 402 par.1 nën par.1.1 të KPPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.43/2017, të datës 20.02.2017

Procesmbajtësi,

Bujar Balaj

Anëtarët e kolegjit:

1.Vahid Halili

2.Abdullah Ahmeti

Kryetari i Kolegjit,

Fillim Skoro
